



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 29 Mars 2021

Nr: 192

VENDIM

PËR DEKLARIMIN TË PËRFUNDUAR DHE PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË SHQYRTIMIT TË REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR ISH-FUNKSIONARIN PUBLIK Z. ERMAL (AGUSTIN) TETEM HASIMAJ, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “n” dhe paragrafi 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 10 paragrafi 1, shkronja “d”, i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe kreut III paragrafi 3, shkronja “ç”, të Vendimit të Kuvendit Nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 398/2 prot., datë 19.03.2021, me lëndë “Dërgohet Vendimi për miratimin e rezultateve të verifikimit” për subjektin vetëdeklarues z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, këshilltar në Këshillin Bashkiak Mallakastër,

VËREJ:

I

1. Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte si më poshtë:
 - Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë;

- Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
 - Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak;
 - Kandidatët për deputet në organet e qeverisjes vendore.
2. Z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, si kandidat i listës shumëmemërore për anëtar në këshillin e bashkisë Mallakastër, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit më datë 11.05.2019, referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
- i. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4627 prot., datë 23.05.2019 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore.
 - ii. Me shkresën nr. V-1745/1 prot., datë 27.05.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka paraqitur vërtetimin se subjekti deklarues z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, figuron me statusin "I Padënuar" brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
 - iii. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me Vendimin Nr. 438 datë 18.05.2019 ka vendosur të njoftojë KZAZ Nr. 51, të vijojë procedurat për regjistrimin e listës shumëmemërore.

II

- Më datë 09.10.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve njoftohet me shkresën nr. 2363 prot. për krijimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mallakastër, si pasojë e dorëheqjes se anëtarit të këshillit bashkiak zj. Katina Hasimaj, i propozuar nga subjekti politik Partia Socialdemokrate.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe nenit 164 të Kodit Zgjedhor, me shkresën nr. 14507/1 datë 15.10.2019, ka njoftuar z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj të dorëzojë formularin e vetëdeklarimit si kandidati i rradhës të cilit i takon mandati për anëtar në këshillin bashkiak Mallakastër, Qarku Fier.
- Më datë 29.10.2019, referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", subjekti vetëdeklarues ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Formularin e Vetëdeklarimit me numër 13683 unik.

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bëri verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit për kandidatin për anëtar këshilli bashkiak ku rezultuan se subjekti ka deklaruar të njëjta të dhëna si në momentin e kandidimit.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresat nr. 14658 prot. datë 25.10.2019 dhe nr. 14657 prot. datë 25.10.2019, ka kërkuar përkatësisht informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr. 8672/1 prot., datë 06.12.2019, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të dhënat personale të subjektit z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, sipas Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Referuar këtyre të dhënave konstatohet se subjekti z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, me atësi Tetem dhe amësi Katina, lindur në Ballsh, Fier më datë 05.08.1989, ka ndryshuar emrin nga “Agustin” në “Ermal”.
- Me shkresën nr. V-3239/1 prot. datë 31.10.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka paraqitur vërtetimin se subjekti deklarues z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj figuron me statusin “I padënuar” brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 1102, datë 06.12.2019, vërejtë se nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, përgjigjes së ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, kandidati nuk ishte në kushtet e moszgjdhshmërisë dhe vendosi të njoftojë këshillin bashkiak Mallakastër të vijojë procedurat e mëtejshme për dhënien e mandatit.

III

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të detyrave të përcaktuara në Kreu V, pika 3, shkronja “ç”, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, për shkak të deklarimit të të dhënave për dëbim nga territori i një shteti të huaj, me shkresën nr. 14971 prot., datë 11.12.2019, ka përcjellë të dhënat e administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për kontroll të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, për subjektin deklarues z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Mallakastër, Qarku Fier.
2. Me shkresën nr. 398/2 prot., datë 19.03.2021, Prokurori i Përgjithshëm, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike”, për subjektin z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, me funksion këshilltar në këshillin bashkiak Mallakastër.

3. Sipas vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme, “Për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj”, rezulton se Prokuroria e Përgjithshme i është drejtuar institucioneve të ndryshme për verifikim të mëtejshëm:
- i. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr. V-3839/1 prot., datë 24.12.2019 ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme dokumentin “Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore nr. 11, datë 23.12.2019”. Nga ky dokument, informohemi se shtetasi z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, i biri i Tetem dhe Katina, i datëlindjes 05.08.1989, lindur në Ballsh, Fier, është “I padënuar”.
 - ii. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 10311/1 prot., datë 17.01.2020, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme të dhënat personale të subjektit z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, sipas Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile. Referuar këtyre të dhënave konstatohet se subjekti z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, me atësi Tetem dhe amësi Katina, lindur në Ballsh, Fier më datë 05.08.1989, i regjistruar banor në zyrën e gjendjes civile të Njësisë Administrative Aranitas, Bashkia Mallakastër, ka ndryshuar përbërësin e gjendjes civile, rubrikën e emrit nga “Agustin” në “Ermal”.
 - iii. Nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS, rezulton se subjekti z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj,
 - ka ato gjeneralitete, të cilat i ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe që janë konfirmuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
 - Nuk rezulton të jetë ndonjë person tjetër me këto të dhëna;
 - Figuron në kategorinë “I deportuar”, regjistruar në pikën kufitare Kakavijë, në vitin 2008 dhe më pas përsëri në kategorinë “I deportuar” disa herë gjatë vitit 2010, në pikën kufitare Kakavijë dhe 1 (një) herë në pikën kufitare Kapshticë.
 - iv. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti i Policisë Kriminale, me shkresën nr. 18319/1 prot., datë 26.12.2019, na informon se nga të dhënat e grumbulluara në sistemin elektronik, subjekti z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, lindur më datë 05.08.1989, nuk ka qenë ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit. Gjithashtu, nga verifikimi në sistem nuk rezulton të ketë të regjistruara gjenealitete të tjera.
 - v. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresat nr. 14962/1 prot., datë 20.12.2019 dhe nr. 958/1 prot., datë 14.01.2020, na informon se nga verifikimet e kryera, shtetasi z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, nuk figuron i regjistruar për veprimtari kriminale si dhe nuk është person i shpallur në kërkim ndërkombëtar. Zyra Interpol/Athinë, Greqi, informon se ky shtetas është i njohur në databazat greke pasi është arrestuar më datë 16.12.2010 nga autoritetet policore të Kastoria, për shkelje të ligjit nr. 3386/2005.
 - vi. Departamenti për Kufirin dhe Emigracionin me shkresën nr. 762/1 prot., datë 11.03.2020 si dhe Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Emigracionin, me shkresën nr. 229/1 prot., datë 09.03.2020, na

informojnë se nga verifikimi kryer në sistemin TIMS, rezulton se ky shtetas është deportuar gjithsej 7 (shtatë), herë nga autoritetet policore greke gjatë periudhës 2008-2010 dhe konkretisht 6 “gjashtë” herë, nëpërmjet pikës kufitare Kakavijë dhe 1 (një) herë, nëpërmjet pikës kufitare Kapshticë. Për shtetasin z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj nuk disponohet asnjë praktikë, pasi për rastet e shtetasve të deportuar, policia greke dorëzon vetëm procesverbalin e dorëzimit së bashku me personin e deportuar në palën shqiptare.

vii. Nga informacioni i përcjellë nga Prokuroritë pranë Gjykatave të shkallës së parë, Gjykatave të Apelit dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, rezulton se ndaj subjektit z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, nuk janë regjistruar procedime penale, nuk ka qenë ose është në hetim, nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi dhe nuk është dënuar me vendim jopërfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale.

viii. Ministria e Drejtësisë pas kërkesave të përsëritura të Prokurorisë së Përgjithshme, me shkresën nr. 915 prot., dhe datë 01.03.2021, ka përcjellë përgjigjet zyrtare të autoriteteve të drejtësisë së Republikës së Greqisë, si më poshtë:

viii/1 Në arkivën e Drejtorisë së Policisë Kostur, Zyra e Sigurisë dhe të huajve figurojnë të regjistruara këto të dhëna;

- Në datë 14.02.2010, është arrestuar nga Departamenti i Ndjekjes së Emigracionit të Paligjshëm në Kozanë, për shkelje të ligjit nr. 3386/2005 “Për të huajt”, dhe ligjit 2696/99 të “Kodit të qarkullimit rrugor”. Ai është dërguar para prokurorit të Gjykatës së Kundravajtjeve të Kosturit dhe është dënuar me një dënim total prej 4 (katër) muajsh dhe 20 (njëzet) ditësh, me pezullim ekzekutimi të dënimit me burgim për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
- Kundër tij është dhënë vendimi i dëbimit me nr. 73/11676-c, i datës 18.02.2010 i Drejtorisë së Sigurisë të Kozanës, në bazë të të cilit u regjistrua në Listën Kombëtare të të Huajve të Padëshiruar (EKANA), dhe në Sistemin e Informacionit Schengen (S.I.S), deri më datë 15.02.2015. Vendimi i mësipërm është ekzekutuar më datë 01.03.2010, nëpërmjet Komisarariatit të Policisë Kapshticë, Follorinë.
- Kundër tij, tashmë nuk ka në pritje asnjë vendim dëbimi-kthimi dhe nuk është i regjistruar në Listën Kombëtare të të Huajve të Padëshiruar ose në Sistemin e Informacionit të Schengen SIS II.

viii/2 Referuar vendimit nr. 176/2010 të Gjykatës së Kundravajtjeve me tre anëtarë Kostur, rezulton se i pandehuri z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, i biri i Tetem dhe Katina, lindur më 05.08.1989, shtetas shqiptar, është shpallur fajtor duke përfitur nga rrethana lehtësuese për shkelje të ligjit 3386/2005 dhe

shkelje të nenit 94, paragrafi 1, 3 5 i ligjit 2696/99 dhe është dënuar me 4 (katër) muaj burgim për veprën e parë dhe 40 (dyzet) ditë, për veprën e dytë. Në përfundim është vendosur një dënim prej 4 (katër) muajsh dhe 20 (njëzet) ditësh si dhe është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim me nr. 11/2010.

viii/3 Referuar vendimit administrativ të dëbimit datë 18.02.2010 të nëndrejtorit të Policisë së Kozanës, rezulton se ndaj shtetasit Agustin Hasimaj, i biri i Tetem dhe Katina për shkak të;

“kryerjes së veprës penale të hyrjes së paligjshme në territorin grek, pa procedurat ligjore (shkelje e nenit 83, pika 1, të ligjit 3386/2005), veprim i cili nga njëra anë tregon se prania e tij në territorin grek është e rrezikshme për rendin dhe sigurinë publike të vendit, pasi ka shkelur ligjin dhe nga ana tjetër përbën shkak të dëbimit administrativ në përputhje me dispozitën 76, pika 1 të ligjit 3386/2005 si dhe për arsye të interesit publik që konsistojnë në nevojën për kontroll efektiv të hyrjes dhe qëndrimit në Greqi të shtetasve të vendeve të treta”, është vendosur:

- dëbimi nga territori i Greqisë, mbasi i jepet një afat prej 48 orësh për të paraqitur kundërshtimet e tij, pasi u arrestua për t’u dëbuar më datë 15.02.2010.
- pezullimin e ekzekutimit të këtij dënimi nëse ai ankimohet.
- regjistrimin e të dëbuarit në Listën Kombëtare të Huajve të padëshiruar (EKANA) dhe në sistemin e informacionit Shengen.

viii/4 Referuar vendimit të datës 03.12.2013, të Gjykatës së Apelit me Tre Anëtarë të Maqedonisë Perëndimore, rezulton se kjo gjykatë, pasi ka marrë në shqyrtim ankesën e shtetasit z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, edhe pse ky i fundit nuk ka qenë prezent në gjykim, ka vendosur:

- Pranimin e ankimit të të pandehurit kundër vendimit 176/2010 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Kundravajtjeve me Tre Anëtarë të Kosturit.
- Pushimin përfundimisht të ndjekjes penale ndaj të pandehurit për shkak të parashkrimit të veprës penale, referuar ngjarjes së datës 14.02.2010, ku ky shtetas u arrestua duke drejtuar një makinë në pronësi të shtetasit S.M, pa qenë i pajisur sipas ligjit me leje drejtimi automjeti.

ix. Për sa më sipër, pas kryerjes së gjithë verifikimeve të mundshme brenda vendit, duke i konsideruar këto verifikime të plota, bazuar në përcaktimet e nenit 8, pikat 1, 2 të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe në përcaktimet e pikës 3, germa “ç”, Kreu III-të dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Kreut V të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të



parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

IV

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme vlerëson se subjekti vetëdeklarues z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj,
- i. Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjeneralitetet e tij dhe është shprehur se ka ndryshuar emrin nga “Ermal” në “Agustin”.
 - ii. Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 4 “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se, është proceduar nga Policia Kufitare, në Kozane, Greqi, për arsye të qëndrimit pa dokumentacion, në vitin 2008-2009, rezultat i së cilës është kthyer në Shqipëri.
 - iii. Po këtu, pyetjes 5 “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se, është caktuar masë e sigurisë arrest me burg e cila është aktualisht në fuqi, nga Gjykata Penale Kozane, Greqi, për veprën penale “Kalim i paligjshëm i kufirit”, vendim i së cilës është deportim në Shqipëri, në vitin 2008-2009.
 - iv. Po këtu, pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se,
 - Ka jetuar në Siçili, Itali, për arsye Turizmi, periudhë të cilën nuk e mban mend.
 - Ka jetuar në Kalkidha, Për arsye turizmi, periudhë të cilën nuk e mban mend.

Pas rezultatit të verifikimit për subjektin z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, me detyrë këshilltar në këshillin e bashkisë Mallakastër, nuk rezulton të ketë indicie për vepra të tjera të kryera brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të parashikuara si ndalime në nenin 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

- b) Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 398/2, datë 19.03.2021 ka njoftuar rezultatet e verifikimit të thelluar sipas së cilës, rezulton e provuar se subjekti vetëdeklarues z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, ka qënë në hetim dhe është gjykuar e dënuar fillimisht për shkelje të

ligjit nr. 3386/05 “Për të Huajt” dhe ligjit nr. 2696/99 “Kodi i Qarkullimit Rrugor”, duke u dënuar me vendimin nr. 176/2010 të Gjykatës së Kundravajtjeve me tre anëtarë, 4 (katër) muaj dhe 20 (njëzetë) ditë duke iu pezulluar ekzekutimi me burgim për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

- c) Rezulton të jetë deportuar/dëbuar 7 (shtatë) herë nga Autoritetet Policore Greke gjatë periudhës 2008-2010. Përkatësisht 6 (gjashtë) herë nëpërmjet pikës kufitare Kakavijë dhe 1 (një) herë nëpërmjet pikës kufitare Kapshticë.

Pas rezultatit të verifikimit për subjektin z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, me detyrë këshilltar në këshillin e bashkisë Mallakastër, nuk rezulton të ketë indicie për vepra të tjera të kryera brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të parashikuara si ndalime në nenin 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Subjekti z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, me shkresën nr. 2760 prot., datë 29.03.2021 ka dhënë dorëheqjen, nga funksioni i tij si këshilltar në këshillin e Bashkisë Mallakastër dhe për rrjedhojë nuk është subjekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, por në zbatim të nenit 8, pika 10 të këtij ligji, thuhet se, nëse verifikimi ka nisur përpara përfundimit të mandatit, procedura e verifikimit kryhet deri në arritjen e konkluzioneve përkatëse.

Për sa më sipër, subjekti vetëdeklarues z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 8, pika 10, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, nenet 90 pikat 2 e 3, 95, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”,



VENDOS:

1. Të deklaroj të përfunduar procedurën administrative pa vendim përfundimtar, për shkak të dorëheqjes së z. Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, nga funksioni i anëtarit të këshillit bashkiak Mallakastër.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

